Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 882/20 859-873-876
Datë/Datum. 11.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.859/20
873/20
876/20
882/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Eurobesi" Sh.p.k.- Prishtinë & GOE "N.N. 100% Design"Sh.p.k.& "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj & Grupi i OE "Limit Project"Sh.p.k. & Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, si dhe OE "Olti Trasing" Sh.p.k - Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "Bashkim Bajramaj B.I.; Mendi -P SH.P.K.; P&I SH.P.K., Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", më datën: 03.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHEN</u>, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Eurobesi"Sh.p.k.- Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik "N.N. 100% Design"Sh.p.k. & "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, grupi i OE "Limit Project"Sh.p.k. & Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, si dhe OE "Olti Trasing" Sh.p.k - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani".

II. <u>ANULOHET</u>, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Eurobesi"Sh.p.k.- Prishtinë, grupi i operatorëve ekonomik "N.N. 100% Design"Sh.p.k. & "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, grupi i OE "Limit Project"Sh.p.k. & Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, si dhe OE "Olti Trasing" Sh.p.k - Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues operatori ekonomik "Eurobesi" Sh.p.k.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.10.2020 me nr. 859/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Grupi i operatorëve ekonomik "N.N. 100% Design"Sh.p.k. & "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 873/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 56.3, 59 dhe 66 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Grupi i operatorëve ekonomik "Limit Project"Sh.p.k. & Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 876/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës" me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39 te RRUOPP-së (sipas nenit 69).

Operatori ekonomik ankues operatori ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 02.11.2020 me nr. 882/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me nr. të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 40 dhe 41 te RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 13.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se: "AK ka vepruar ne kundërshtim duke na eliminuar padrejtësisht me arsyetimin se nuk i plotesojm kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional dhe atë: "1. Ne ju njoftomi se vlerësimi është bërë konform ligjit dhe se ju nuk jeni me ofertë te përgjegjshëm duke mos i plotësuar dy kërkesa si me poshtë.

2. I nderuar OE ,ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK,te publikuara ne dosjen e tenderit te:Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr. 4

1. Kërkesa 4. Stafi i inxhinierëve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës -Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstrukt -Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik -Një (1) inxhinier Mekanik.

1 .Inxhinieri i arkitekturës Benjamin Halit Kabashi i cili ka regjistruar studimet e ciklit të dytë në një fakultet jashtë Kosove me 10.10.2011, ka kryer studimet pesëvjeçare me 300 ECTS kredi dhe ka marrë diplomën më 15.12.2016 dhe ka të nostrifikuar për përdorim në Kosovë më 05.09.2018 gjë që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvojë pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

2. Po ashtu ne kërkesën e njëjtë Inxhinieri i ndërtimtarisë Arbon Prekadini ka përfunduar studimet e tij master dhe fituar titullin Master i Shkencave Teknike të Ndërtimtarisë më 15.05.2017 që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvojë pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **nuk është i bazuar** sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon:

Kërkesa 2. Menaxher i projektit- Inxhinier i dip. ose kualifikimi Master i ndërtimtarisë ose i Arkitekturës me min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)

Kërkesa 3. Menaxher i Punishtes - Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i Ndërtimtarisë me min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar.

Kërkesa 4. Stafi i inxhinierve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës -Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv

-Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik - Një (1) inxhinier Mekanik.

Kërkesa 5. Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin. Vendimi për caktimin e menaxherit.

Dëshmia 3. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës

së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin.

Dëshmia 4. Inxhinierët të dokumentojnë diplomat universitare (kopje) master apo diploma me studime 5 vjeçare(autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit sipas profilit të drejtimit, CV ,kontratë punës.

Eksperti shqyrtues konstaton se nga kërkesat dhe dëshmitë e kërkuar në piken 2, 3 dhe 4 respektivisht te parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit shihet qartë se janë kërkuar 1 Menaxher i projektit inxhinier i ndërtimtarisë ose i arkitekturës , 1 Menaxher i Punishtes inxhinier i ndërtimtarisë si dhe 5 inxhiniera nga një për secilën fushë respektivisht:

1. Një (1) inxhinier i Arkitekturës
2. Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv
3. Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik
4. Një (1) inxhinier Elektrik
5. Një (1) inxhinier Mekanik

bazuar në kërkesat e AK OE pjesëmarrëse është dashur të dorëzojë dëshmitë sipas kërkesës së AK, për 7 inxhinierë që do t'i angazhoj në implementim të kontratës.

Ndërsa Operatori ekonomik ankues ka dorëzuar listën e stafit profesional për këtë projekt në përbërje si vijon:

Nr	Emri	Mbiemri	Mosha	Përvoja	Pozita në Kompani
1	Sinan	Berisha	56 Vite	15 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures **Projekt Menaxher**
2	Samil	Pireci	46 Vite	13 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë **Menaxher i Punishtës**
3	Arbon	Prekadini	34 Vite	11 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
4	Becir	Zecirovic	56 Vite	25 Vite	Inxh.Dipl.Hidroteknikes
5	Lulzim	Kryeziu	46 Vite	21 Vite	Inxh. Dip. Makinerisë
6	Qamil	Hoti	51 Vite	18 Vite	Inxh.Dip.Elektroteknikës
7	Besian	Sinani	35 Vite	6 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
8	Benjamin	Kabashi	33 Vite	8 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures

Mirëpo OE ankuese nuk ka ofruar dëshmitë konform kërkesës së AK lidhur me Inxhinierin e Ndërtimtarisë z .Arbon Prekadini si dhe Inxhinierin e Arkitekturës z.Benjamin Kabashi.

Për Inxhinieri e ndërtimtarisë z. Arbon Prekadini ka dorëzuar: kontratë pune për kohë të pacaktuar, Cv, diplomën për përfundimin e studimeve master te lëshuar me datën 26.5.2017 nga Fakultetit i Ndertimtaris dhe Arkitekturës në Prishtinë, me te cilën ka fituar titullin Master i Shkencave Teknike të Ndertimtarisë me 15.05.2017, nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi (referencë apo dokument tjetër) mbi përvojën e punës, andaj nga deshmit e bashkangjitura rrjedh se i njëjti nuk ka përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit siç ka kërkuar AK, si dhe, Për Inxhinierin e arkitekturës z. Benjamin Halit Kabashi parakontraten për angazhim në projekt, Cv, diplomën për përfundimin e studimeve master te lëshuar me datën 15.12.2016 nga Fakultetit

i Arkitekturës dhe Dizajn, Universiteti Polis, në Republikën e Shqipërisë, me te cilën ka fituar titullin Master i Shkencave në Arkitekture dhe Dizajn me 23.07.2012, dhe të njëjten diplomë e ka nostrifikuar dhe njohur gradën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 6 4203 te datës 05.09.2018, nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi (referencë apo dokument tjetër) mbi përvojën e punës, andaj nga deshmit e bashkangjitura rrjedh se i njëjti nuk ka përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit/nostrifikimit siç ka kërkuar AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ndërlidhet me arysjen tjetër të eliminimit respektivisht si vijon:, kërkesa nr 5 si me poshtë e kërkuar nga AK ne dosje te tenderit.

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe përgatitje shkollore numri i punëtorëve 30 dhe te ketë kontrata me punëtor ose parakontrata. Punëtorë të profileve të ndryshme.

Ne kemi gjetur këto te dhëna ne listën e stafit te punëtoreve qe bien ne kundërshtim me DT, dhe kërkesat e AK,

3. Lista e stafit nuk është e plotësuar me 30 punëtorë sipas DT. Në listën prej 38 punëtorëve janë të përfshirë edhe punëtoret profesional (inxhinierët), administrative dhe juridik, si dhe punëtorët e ndërtimtarisë.

Bazuar në ARBK N.P. "Euro-Besi" është themeluar me 11.03.2004 si Biznes Individual e cila është shëndruar në SH.P.K. "Euro-Besi" me numër të ri biznesi 71211568 më 30.10.2015, ndërsa kemi gjetur se disa nga punëtorët të cilët janë të përfshirë në listën e stafit kanë kontrata pune të lidhura si psh:

- Personi me nr ID 1019566621 me datë 01.12.2014 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1006445914 me date 01.01.2011 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1179074704 me datë 01.01.2011 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1002777661 (njëkohësisht me vendim për menaxher punishte) me datë 06.01.2014 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1012376720 me date 01.01.2014 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1170555321 me datë 20.03.2012 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;e."

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **është pjesrishtë i bazuar** sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon:

Kërkesa 5. Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe përgatitje shkollore numri i punëtorëve 30 dhe te ketë kontrata me punëtor ose parakontrata. Punëtorë të profileve të ndryshme..

Ndërsa, OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën në të cilën ka përfshirë të dhënat e 38 punëtorëve (në këtë listë ka përfshirë 6 nga 8 inxhinieret te cilët i ka përfshirë edhe në listën e stafit profesional si dhe 4 punëtor të administratës) dhe listën e me të dhënat e 8 punëtorëve/stafit profesional me profile të ndryshme, nga të dy listat rrjedh se OE ankuese për këtë aktivitet të prokurimit ka paraqitur 40 punëtor/staf me profile të ndryshme.

Lidhur me personat/stafin me të dhënat: personi me nr ID 1019566621; Personi me nr ID 1006445914; Personi me nr ID 1179074704 ; Personi me nr ID 1002777661; Personi me nr ID 1012376720 si dhe Personi me nr ID 1170555321 eksperti shqyrtues konstaton se për të njëjtit persona OE ankuese ka bashkangjitur kopjet e kontratave të punës të cilat janë të nënshkruara në vitet 2011, 2012 dhe 2014 ndërsa të njëjtat janë te vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK e cila është formuar me datën 30.10.2015 respektivisht në vitit 2015 është ndërruar statusi i kompanisë nga "NP EuroBesi" në "EuroBesi shpk' dhe sipas sqarimit te OE ankuese për te njëjtit punëtor te cilët kane qene të punësuar në kompani edhe para ndryshimit të statusit ndërsa pas ndryshimit të statusit nga "NP EuroBesi" në "EuroBesi shpk'' janë leshuar kontratat dhe jane vertetuar me vule "EuroBesi shpk''. Po ashtu OE ankuese si deshmi se bashku me ankesen ka bashkangjitur listat e te punesuareve te deklaruar në ATK për vitin 2014 dhe 2020 në të cilat lista figurojn të dhënat e të gjithë personave me numer personal te cilet janë specifikuar më lartë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim **nuk është i bazuar** sepse me paragrafin 1.1 te pikës 1 te nenit 60 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm** me çmimin më të ulët".

Përgjigje në pretendimet ankimore të grupit të OE "N.N. 100%Design" Sh.p.k.&"Termomontimi" Sh.p.k-Skenderaj - Ankesa 873/20 Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 56.3, 59 dhe 66 të LPP-së, me arsyetimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me arsyen e eliminimit të saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me deshmit e referencave - vlera e punëve të kryera të ngjashme, deshmit se projektmenaxheri i ka kryer tri projekte te mëdha-kontratën e skaduar dhe inxhinieri i ndërtimit është me studime bachelor"

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese është pjesrishtë i bazuar sepse grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listen e projekteve të realizuara nga OE "N.N. 100% Design"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 13,903,937.79 € të kontratave të realizuara nga viti 2014 deri në vitin 2020 si dhe listën e projekteve të realizuara nga OE "Termomontimi" Sh.p.k në të cilën figuron vlera totale prej 3,773,070.30 € të kontratave të realizuara nga viti 2016 deri në vitin 2020, mirëpo në të dy listat janë të përfshira kontrata të cilat kanë përfunduar para datës 08.09.2017 dhe vlerat e atyre kontratave nuk i përkasin periudhes së 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit përkontratë, janë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, asfaltim, montime, kontratat e komplekseve banesore pa pranime teknike si dhe vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër, andaj eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha vlerat e ketyre kontratave që janë specifikuar më lartë nuk janë konform kërkesës së parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga AK, ku është kërkuar që operatoret ekonomik duhet të ofrojnë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduara me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €. Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese nuk është i bazuar.

Ndërsa lidhur me deshmit e dorëzuar për projektmenaxherin e kontratës eksperti shqyrtues konstaton se grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Hajrullah Lushtaku projektmenaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të arkitekturës te lëshuar ne vitin 2006 dhe të vërtetuar tek noteri, CV të nënshkruar, kontratën e punës mbi angazhimin e të njëjtit për aktivitetin në fjalë si dhe referencën e lëshuar nga kompania "N.N. 100% Design"Sh.p.k., këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se në CV dhe referencën e projektmenaxherit është cekur dhjetëra projekte nga te cilat mund të konstatohet se i njejti ka menaxhuar më shumë se tri projekte të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00

€) sipas kërkesës së AK "së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)". Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankuese në dokumentacionin e grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në deshmit lidhur me CV e projektmenaxherit, certifikatën e TVSH te partnerit "P&I" si dhe deshmit lidhur me vërtetimet tatimore dhe certifikatat e gjykatës për të gjithë partneret e konzorciumit."duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se grupi i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar së bashku me dosjen e tenderit, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Faruk Bytyqi projektmenaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të ndertimtaris dhe të vërtetuar tek noteri, CV të pa nënshkruar, kontratën e punës mbi angazhimin e të njejtit për aktivitetin në fjalë si dhe referencat e lëshuar nga kompania "N.P.N. Bajramaj", këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, sepse përkundër që CV-ja e projektmenaxherit nuk është e nënshkruar, ky është një devijim i vogël i cili nuk përbën element për ndryshim thelbësor apo material të ofertës sepse i njëjti është inxhinier i ndërtimtarisë sipas kërkesës së AK dhe në bazë të referencave të lëshuara për të, konstatohet se i njejti ka menaxhuar tri projekete të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00 €) sipas kërkesës së AK *"së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)"*. Si dhe grupi i OE të rekomanduar për kontratë, pas kërkesës së AK para publikimit të formularit "B58 vendimit mbi njoftimi e AK" në platformën e E-prokurimit, kanë dorëzuar në AK, certifikatën e TVSH te partnerit "P&I" si dhe deshmit lidhur me vërtetimet tatimore dhe certifikatat e gjykatës për të tre anëtaret e konzorciumit, të gjitha këto certifikata pas sqarimit të këkuarë nga eksperti shqyrtues, AK i ka publikuar në platformën e E-prokurimit me datën 05.11.2020 si dhe të njëjtat i ka përcjell tek eksperti përmes e-mailit. Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të grupit të OE "Limit Project"Sh.p.k. &Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë- Ankesa 876/20

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së si dhe nenin 39 të RRUOPP, me arsyetimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me mos dhënien e njoftimit respektivisht mos dërgimit/publikimit të letrës standarde nga AK se pse janë eliminuar, pretendimet mbi arsyet e eliminimit të saj nga AK që

ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht pretendimit se i plotësojnë të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK "

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se AK e ka elimunar grupin e OE ankuese me arsyetimin si vijon:

"ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK, te publikuara ne dosjen e tenderitte: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr.2, Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €

"Limit Projekt" Sh.P.K., "DAR ING" Sh.P.K., "Rinesa" Sh.P.K., "ARBOTEC" Sh.P.K.

1. Mungon referencat në vlerë prej 3 200 000.00 euro në punë të kryera të ngjajshme sipas DT. Nuk hyjnë punimet e përfunduara para dates 08.09.2017 pasi që ato duhen të jenë në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit nga AK. Në referencat e ofruara në DT të ofruara nga OE nuk përkojnë me kërkesat dhe kriteret e kapacitetit teknik dhe professional:

- Renovimet;
- Asfaltimi i rrugëve;
- Fasadimet;
- Punët e instalimeve;
- Punët ujësjells dhe kanalizim;
- Punët e mirëmbajtjeve;
- Furnizimet dhe montimet;
- Punët që janë në vazhdim;
- Komplekset banesore pa pranime teknike nga organet kompetente."

Ndërsa grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listen e projekteve të realizuara nga OE **"Limiti" Sh.p.k.** në të cilën figuron vlera totale prej 3,168,964.89 € të kontratave të realizuara dhe që janë implementim e sipër nga viti 2019 deri në vitin 2020, listën e projekteve të realizuara nga OE **"Rinesa"Sh.p.k.** në të cilën figuron vlera totale prej 1,958,866.64 € të kontratave të realizuara nga viti 2017 deri në vitin 2020, listën e projekteve të realizuara nga OE **"Doring"Sh.p.k.** në të cilën figuron vlera totale prej 113,847.56 € të kontratave të realizuara nga viti 2017 deri në vitin 2018 si dhe listën e projekteve të realizuara nga OE **"Engroup"Sh.p.k.** në të cilën figuron vlera totale prej 2,359,993.57 € të kontratave të realizuara nga viti 2016 deri në vitin 2019, mirëpo në këto lista janë të përfshira kontrata të cilat kanë përfunduar para datës 08.09.2017 dhe vlerat e atyre kontratave nuk i përkasin periudhës së 3 viteve të

fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, po ashtu për periudhën e fundit 3 vjeçare në listë janë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, montime, kanalizime, kontratat e kompleksève banesore pa pranime teknike nga palë të treta si dhe vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër (të pa përfunduara), andaj eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha vlerat e ketyre kontratave që janë specifikuar më lartë nuk janë konform kërkesës së parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga AK, ku është kërkuar që operatoret ekonomik duhet të ofrojnë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme **(ndërtime te larta) te përfunduara** me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se vetëm në listën e projekteve të realizuara nga OE "Engroup"Sh.p.k. janë përfshirë dy projekte të cilat kanë përfunduar dhe për te cilat janë bashkangjitur referenca si dhe i takojn periudhes së fundit 3 vjeqare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (08.09.2017 deri 08.09.2020) siç ka kërkuar AK, por të cilat nuk e plotësojn kërkesen e AK-së, këto projekte janë:

Projekti	**Autoriteti Kontraktues**	**Vlera e Kontrates**
Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Rubovc faza II	Komuna e Lipjanit	177,876.11 €
Ndërtimi i shkollës fillore në Fushë Kosovë -faza e dytë	Komuna e Fushë Kosovës	239,957.11 €
Vlera totale e projekteve të realizuara		**417,833.22 €**

Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese **nuk është i bazuar**.

Lidhur me pretendimet e OE ankuese se nuk janë njoftuar nga AK respektivisht mos dergimit/publikimit të letrës standarde nga AK se pse janë eliminuar duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se AK, në platformën e E-prokurimit me rastin e ngarkimit të "B58 vendimit mbi njoftimi e AK" nuk ka bashkangjitur asnjë letrat standarte mbi rezultatet e nxjerrura rreth ofertave të operatorve ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky fakt vërtetohet edhe nga e-mailat e bashkangjitur me ankes, me të cilet konstatohet komunikmi i zyrtarve të AK më përfaqsusit e operatorit ekonomik ku është specifikuar se për shkak të problemeve me platformen e E-prokurimit nuk ka qenë e mundur publikimi i letrave standarte në platformen e E-prokurimit. Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE ankuese rreth deshmive/dokumentacionin te grupit te OE te rekomanduar për kontratë respektivisht në deshmit lidhur me marreveshjet e konzorciumit/jane prezentuar dy marreveshje

konzorciumi, ku nje kompani ka lidhur me dy kompani marreveshje komplet te ndara me njera tjetren ne kundershtim me formimin e grupit sipas ligjit si dhe i njejti grup ka mangesi edhe tek stafi profesional, pervoja si kompani si grup komplet nuk i permbushin kriteret në FDT. " duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se grupi i operatorve ekonomik të rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dy marrëveshje konzorciumi respektivisht lideri i grupit ka lidhur marrëveshje të veçanta të konzorciumit me anëtaret tjerë te konzorciumit, praktik jo e zakonshme, mirëpo bazuar në paragrafin e fundit të pikes 71.1 të nenin 27 të RRUOPP ku thuhet *"Deklaratat e kërkuara nen (a),(b) dhe (c)* ***mund*** *të përfshihen në një dokument "* nga kjo rrjedhimisht mund të konstatojmë se bazuar në legjislacionin për prokurim publik nuk është obligative që themelimi i grupit të bëhet vetëm me një marrëveshja/deklarate konzorciumi.

Ndërsa lidhur me pretendimit e cekur sipërfaqësisht pa paraqitur asnjë fakt nga OE ankuese rreth stafit profesional të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton se grupi i OE të rekomanduar për kontratë se bashku me dosjen e tenderit lidhur me stafin profesional kanë paraqitur kopjet e diplomave, CV, kontratën e punës si dhe referencat mbi përvojën e punës për 9 inxhinier të profileve të ndryshme. Andaj pretendimet e OE ankuese në këtë pikë nuk janë të bazuara.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë- Ankesa 882/20

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 40 dhe 41 të RRUOPP, me arsytimin se:

> "OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me arsyen e eliminimit të saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me deshmit kontratën e punës – inxhinierin/menaxherin e projektit z.Kreshnik Raci dhe deshmit lidhur me listen e projekteve te realizuara ne vlere 3, 200, 000.00 € si dhe në krahasim me oferten e grupit te OE te rekomanduar për kontratë ne vlerë 1,790,297.61 € çmimi i ofertes tonë/OE ankuese ka qenë 1,683, 937.17 € respektivisht nese shumes1,790,297.61 € i zbritet- 1,683, 937.17 € = 107,000.00 € që paraqet nje shume te konsiderushme dhe se oferta jone i ploteson te gjitha kriteret te cilat kane qene te specifikuara ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumetet te cilat e perbejne dosjen e tenderit."

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese është pjesrishtë i bazuar sepse grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listën e projekteve të realizuara nga OE "Olti Trasing"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale

prej 30,251,554.96 € të kontratave të realizuara nga viti 2008 deri në vitin 2019 si dhe në fund të listës është specifikuar se "Totali i realizimit për tre vitet e fundit" është 7,066,245.85 € , mirëpo në listë janë të përfshira kontrata të cilat kanë përfunduar para datës 08.09.2017 dhe vlerat e atyre kontratave nuk i përkasin periudhës së 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, po ashtu për periudhën e fundit 3 vjeçare në listë janë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, montime, kontratat e kompleksève banesore pa pranime teknike nga palë të treta(por është bashkëngjit një raport i inxhinierëve për vetë OE) si dhe vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër (të pa përfunduara), andaj eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha vlerat e këtyre kontratave që janë specifikuar më lartë nuk janë konform kërkesës së parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga AK, ku është kërkuar që operatoret ekonomik duhet të ofrojnë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndërtime te larta) te përfunduara me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se në listën e projekteve të realizuara nga OE "Olti Trasing"Sh.p.k. janë përfshirë vetëm disa projekte të cilat kanë përfunduar dhe për te cilat janë bashkangjitur referenca/pranime teknike si dhe i takojnë periudhës së fundit 3 vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (08.09.2017 deri 08.09.2020) siç ka kërkuar AK, por të cilat nuk e plotësojnë kërkesën e AK-së, këto projekte janë:

Projekti	**Autoriteti Kontraktues**	**Vlera e Kontrates**
Ndërtimi i një etazhe (nen kulem) në DR.Ferizaj Salla operative	Policia e Kosovës	98,840.98 €
Ndërtimi i pikës O në Burgun e sigurisë së lartë	Ministria e Drejtësisë	64,531.02 €
Ndërtimi i aneksit te objektit të Gjimnazit "Hamdi Berisha" Malishevë	Komuna e Malishevës	256,060.67 €
Ndërtimi i katit të tretë në DR Prizren	Policia e Kosovës	219,226.36 €
Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it LOT 10 *(kontrata është nënshkruar në nëntor të vitit 2016).*	Ministria e Administratës Publike	1,643,051.43 €
Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it punë të pa parapara Aneks Kontratë	Ministria e Administratës Publike	38,022.36 €
Vlera totale e projekteve të realizuara		**2,319,732.82 €**

(në këtë vlerë është përfshirë edhe vlera e kontratës se ndërtimit te ndërtesës së IKAP- periudha muaj nëntor 2016 deri shator 2017)-

dhjetë muaj jashtë periudhës se fundit 3 vjeçare (08.09.2017 deri 08.09.2020).

Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese **nuk është i bazuar**.

Ndërsa lidhur me deshmit e dorëzuar për projektmenaxherin e kontratës eksperti shqyrtues konstaton se operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Kreshnik Raci projektmenaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të arkitekturës te lëshuar ne vitin 2006 dhe të vërtetuar tek noteri, CV të nënshkruar, kontratën e punës për kohe te caktuar e lidhur 01.07.2020 në kohëzgjatje deri më 30.09.2020 (nga te cilat data vërtetohet se kontrata ka qenë me afatë në kohen kur u dorëzuar oferta e jo siç kanë konstatuar AK se është e skaduar) si dhe referencat e lëshuar nga kompania "Olti Trasing"Sh.p.k, fondacioni Albanian-American dhe USAID, këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se në CV dhe referencat e projektmenaxherit janë cekur dhjetëra projekte nga te cilat mund të konstatohet se i njëjti ka menaxhuar më shumë se tri projekete të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00 €) sipas kërkesës së AK "së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas ksasifikimit të kontratave të LPP-së)". Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se oferta e tyre është në shumë të konsiderueshme më e lirë se sa oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se autoritet kontraktues respektivisht komisioni vlerësues është i obliguar që me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave të zbatojnë paragrafin 1.1 te pikës 1 te nenit 60 të LPP-së ku thuhet se: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara, ndërsa rekomandon që të mbetet ne fuqi njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues. konfirmojmë pranimin e shkresës dhe ne pajtohemi me mendimin e ekspertit lidhur me lëndë me nr 859-873-876-882-20 eksp. dhe mendoi edhe unë se është i bazuar .

Operatori Ekonomik, "Eurobesi"Sh.p.k., Prishtinë me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PËRGJIGJE NË MENDIMIN E EKSPERTIT (859-873-876-882-20)

"Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës " me numcr te prokuriinit 97800-20-5047-5-1-1 dhe nr te brendshëm: 208/20/020/511

Ne me vëmendje e analizuam mendimin e ekspertit ne lidhje me ankesën tone për kete projekt dhc ne NUK pajtohemi me ketë mendim te ekspertit sepse ky ekspert nuk ka analizuar ne delaje dosjen e tenderit dhe po ashtu nuk ka marr parasysh ankesen tone me te cilen kemi deshmuar qe jemi kompani e pergjegjeshme ne kete tender.

Pergjigja jone ne lidhje me pikat ku eksperti i ka marr pretendimet tone si te PA BAZUARA eshte kjo:

Kerkesa e dosjes se tenderit per stafin profesional ka qene qe OE duhet te kene Nje (1) Projekt Menaxher , Nje (1) Menaxher te punishtes dhe Pese (5) inxhiniere tjere te lemive te caktuara ne dosje. Sa i perket menaxherit te projcktit dhe inenaxherit te punishtes ne kemi plotesuar kete kerkese dhe nuk jane kontestuar nga AI< dhe as nga Eksperti.

Sa i perket stafit tjeter prej Pese (5) inxhinierve tjere kerkesa e dosjes se tenderit eshte plotesuar nga nc si OE ofertues pasi qe ne per kete pike kemi prezentuar stafin c plote dhe qe e ploteson kriterin e dosjes se tenderit :Kerkesa 4. Dhe Deshmia 4 si me posht:

Kërkesa 4. Stafi i inxhinierve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës - Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv -Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik -Një (1) inxhinier Mekanik.

Ne ne dosje te tenderit per këtë staf kemi prezantuar inxhinieret si me poshtë:

Nr	Eimri	Mbiemri	Mosha	Përvoja	Pozita në Koinpani
1	Sinan	Berisha	56 Vite	15 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures Projekt Menaxher
2	Samil	Pireci	46 Vite	13 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë Menaxher i Punishtës
3	Arbon	Prekadini	34 Vite	11 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
4	Becir	Zecirovic	56 Vite	25 Vite	Inxh.Dipl.Hidroteknikes
5	Lulziin	Kryeziu	46 Vite	21 Vitc	Inxh. Dip. Makinerisë
6	Qainil	Hoti	51 Vite	18 Vite	Inxh.Dip.Elektroteknikës
7	Besian	Sinani	35 Vite	6 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
8	Benjamin	Kabashi	33 Vite	8 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures

me BOLD janë stafi qe plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Inxhinier i Ndërtimtarisë - z.Besian Sinani i cili plotëson kriteret e dosjes se tenderit dhe nga AK dhe po ashtu nga Eksperti NUK është marre për baze fare ne VLERESIM mirëpo ata kane marr për baze inxhinierin z.Arbon Prekadini i cili është staf i kompanise andaj dhe figuron ne listën e dorëzuar, mirëpo nuk merret për

baze ne vlerësim sepse këtë kriter e kemi plotësuar me z.Besian Sinani për te cilin kemi bashkangjitur Para Kontratën, CV dhe Diplome e tije , pandaj kërkojmë nga Paneli Shqyrtues qe te vlerësoj Inxhinierin z.Besian Sinani dhe për kete pike te na shpall si te përgjegjshëm sepse jemi plotësisht te përgjegjshëm sepse nuk mundet AK dhe as Eksperti to mos na merr për baze z.Besian Sinani i cili është ne listën e stafit dhe i cili plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Inxhinieri i Arkitektures - z.Benjamin Kabashi për këtë inxhinier edhe Eksperti Shqyrtues e ka pranuar qe diplomimi i tije është data 23.07.2012 dhe jo data e marrjes se dokumentit te diplomës siç ka pretenduar AK ,mirëpo ne nuk pajtohemi me Ekspertin qe nuk kemi bashkangjitur dëshmi te mjaftueshme qe dëshmojnë përvojën 5 Vjeçare sepse data e diplomimit është data 23.07.2012, CV e tije dëshmon përvojën e punës se tije me shume se 5 vjeçare ndërsa **REFERENCA** nuk ka qene kërkese e dosjes se tenderit për 5 Inxhinieret sipas kërkesës nr4 dhe Dëshmisë nr 4 ,mirëpo edhe nëse kishte me qene kërkese atëherë AK është dashtë te zbatoj nenin 72 te LPP-se dhe pikës 39.8 te RRUOPP-se duke kërkuar informacione shtese.

Nostrifikimi i diplomës nuk ka qene kërkese e AK ne dosjen e tenderit dhe po ashtu nuk ka qene kërkesë qe përvoja e punës te dëshmohet pas Nostrifikimit te diplomës.

Përvoja e punës dëshmohet me datën e diplomimit dhe me CV sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Sa i përket listës se punëtoreve Eksperti Shqyrtues ka qene dashtë qe këtë pretendim tonin ta merr si TE BAZUAR dhe jo Pjesërisht te Bazuar sepse ne këtë pike ne jemi plotësisht te përgjegjshëm.

Sa i përket Nenit 60 te LPP-se ne prapë qëndrojmë pas pretendimit tone qe AK ka bere shkelje gjate vlerësimit te ofertave sepse nuk ka bere vlerësim real sepse ne kcte dosje te tenderit ne jemi kompania e përgjegjshme me çmimin me te ulet.

Kërkojmë nga OSHP qe inxhinieri Besian Sinani te vlerësohet ne këtë dosje te tenderit sepse AK dh Eksperti nuk e kane vlerësua apo ndoshta nuk c kane pa ne listën e dorëzuar dhe po ashtu inxhinieri Benjamin Kabashi te vlerësohet qe ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit dhe përvojën e punës.

Kërkojmë nga OSHP qe pretendimet tona te merren si le BAZUARA dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM nc te kundërtën ne do te ndjekim rrugët tona ligjore ne Gjykatën Themelore- Departamenti për Çështje Administrative.

Grupi i OE "N.N. 100% Design"Sh.p.k.& "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, me datë: 16.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Grupi i OE "Limit Project"Sh.p.k.& Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë. , me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, lidhur me një sqarim te **kërkesës për rishqyrtim**

me date 31.10.2020, kemi parashtruar ankesë, ndaj: Universiteti i Prishtinës "Universiteti i Gjakovës - FEHMI AGANI", për tenderin Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës, AK Universiteti i Gjakoves Fehmi Agani, po vazhdon ende me proceduren e prokurimit.

Ne po ju foreardojme e-mailin e AK kur na ka njoftuar per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim, dhe eshte data 22.10.2020 dhe gjithashtu nuk eshte pergjigja ndaj nesh ne kete rast, pra brenda dites kemi pranuar 2 e-mail per njoftim te refuzimit,nderkohe qe shume thjeshte, AK ka mundur te vendose edhe daten e marrjes se vendimit per refuzim, si dhe ka mundur te ngarkoje vendimin ne ëëë.E-prokurimi.rks-gov.net

Ne njoftimin ne formatin ëord, nuk shkruan asnje date kur eshte marre vendimi nga AK.
Ndersa, ne jemi te shqetesuar qe AK po vazhdon me procedurat sikur te mos kemi paraqitur ankese ne fare.

Ju lutemit e nderrni masat e duhura, ose na njoftoni per arsyeshmerine, pasiqe AK, ka pasur mundesi te na njoftoje me kohe per veprimet dhe refuzimet, ndersa ne jemi njoftuar 6 dite pas dergimit te kerkeses per rishqyrtim....

Duke shpresuar ne mirekuptimin tuaj, LIMIT PROJECT SH.P.K. & "ARBOTEC" SH.P.K.& Rinesa SH.P.K& DAR ING SH.P.K.& ENGRUP SH.P.K

VENDIM MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË INICUARA NGA OE. NPN EUROING SH.P.K. Refuzohet kërkesa për rishqyrtimin e OE.
" lidhur me aktivitetin e prokurimit , "Ndertimii Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës" numër të prokurimit:97800-20-5047-5-1-1,iniciuar nga Universiteti i Gjakovës i dt. 04.09.2020..
Mbetet në fuqi Njoftimi për dhënie të Kontratës i AK Universiteti i Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit ""Ndertimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës>numër të prokurimit 97800-20-5047-5-1-1,
ARSYETIM
OE. 1.3. Marisa SH.P.K.si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran Universitetin e Gjakovës"me dt. 17.10.2020 ne ora 15:35...kundër njoftimit për dhënie të kontratës""Ndertimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës'me numër të prokurimit 97800-20-5047-5-1-1,,duke pretenduar se janë bërë shkelje të ligjit të prokurimit Publik, dhe atë në:
1.Ne ju njoftomi se vlerësimi është bërë konform ligjit dhe ne kemi kërkuar nga komisioni i vlerësimit përgjigje prapë për kërkesat për shqyrtim nga OE,Komisioni i vlerësimit kanë qen eksperta te fushës se

ndërtimit dhe përgjigjja e tyre është se ju nuk jeni me ofertë te përgjegjshëm duke mos i plotësuar disa kërkesa si me poshtë.

2.Inderuar OE,ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK,te publikuara ne dosjen e tenderitte:Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr.2,4

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €

Marisa" Sh.P.K., "VICTORY COM" N.T.Sh., N.N.P. "VETONI", "ART CONSTRUCTION" Sh.P.K.

2. Mungon referencat në vlerë prej 3 200 000.00 euro në punë të kryera të ngjajshme sipas DT. Nuk hyjnë punimet e përfunduara para dates 08.09.2017 pasi që ato duhen të jenë në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit nga AK. Në referencat e ofruara në DT të ofruara nga OE nuk përkojnë me kërkesat dhe kriteret e kapacitetit teknik dhe professional:
    - Renovimet;
    - Asfaltimi i rrugëve;
    - Fasadimet;
    - Punët e instalimeve;
    - Punët ujësjells dhe kanalizim;
    - Punët e mirëmbajtjeve;
    - Furnizimet dhe montimet;
    - Ndërtimi i urave;
    - Ndërtimi i garazhave 30 m^2;
    - Ndërtimi i shtëpive B+1;
    - Punët që janë në vazhdim;
    - Komplekset banesore pa pranime teknike nga organet kompetente.

Kërkesa 2. Menaxher i projektit- Inxhinier i dip. ose kualifikimi Master i ndërtimtarisë ose i Arkitekturës me min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas ksasifikimit të kontratave të LPP-së)

2Mugojnë referencat për projekt menaxherin.

Kërkesa 6. Raportin për veglat dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit. Vegla dhe pajisje teknike ne baze te specifikave te projektit.

6 Kërkesa i Mungon lista e veglave.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pran OSHP-së .

Vendimi ju dorëzohet:

1. OE ankues
2. Arkivit të Ugjfa-së

Operatori ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë, me datë: 16.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet pjeserisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me date 13.11.2020 kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së me numër të protokollit 882/20 të datës 13.11.2020.

-Raporti i ekspertit shqyrtues që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Fakultetit të Mjekësisë te Universitetit të Gjakovës" me numër të prokurimit: 97800-20-5047-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani".

Ne pajtohemi pjesërisht me këtë raport të ekspertit shqyrtues.

Mbetet që në seancën e shqyrtimit kryesor të panelit shqyrtues të OSHP-së, ku do të jetë i pranishëm edhe zyrtari ynë i autorizuar dhe pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve ankimore edhe një herë të nxirret një vendim meritor.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 03.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se per këtë Aktivitet te Prokurimit Operatoret ankues kane ofertuar me këto çmime:

"Eurobesi" Sh.p.k	ka ofertuar me çmim prej:	1,750,030.51
N.N. "100% Design"Sh.p.k.	ka ofertuar me çmim prej:	1,594,982.05
"Limit Project"Sh.p.k.	ka ofertuar me çmim prej:	1,597,917.58
"Olti Trasing" Sh.p.k	ka ofertuar me çmim prej:	1,683,937.14

dhe OE i rekomanduar për kontratë **Bashkim Bajramaj B.I** 1,790,297.61

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues "Eurobesi" Sh.p.k.

Lidhur me pretendimin se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me arsyetimin se: "AK ka vepruar ne kundërshtim duke na eliminuar padrejtësisht me arsyetimin se nuk i plotësojmë kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional dhe atë: "1. Ne ju njoftomi se vlerësimi është bërë konform ligjit dhe se ju nuk jeni me ofertë te përgjegjshëm duke mos i plotësuar dy kërkesa si me poshtë.

2. I nderuar OE, ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK, te publikuara ne dosjen e tenderit te: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr. 4

1.Kërkesa 4. Stafi i inxhinierëve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës -Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstrukt -Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik -Një (1) inxhinier Mekanik.

1 .Inxhinieri i arkitekturës Benjamin Halit Kabashi i cili ka regjistruar studimet e ciklit të dytë në një fakultet jashtë Kosove me 10.10.2011, ka kryer studimet pesëvjeçare me 300 ECTS kredi dhe ka marrë diplomën më 15.12.2016 dhe ka të nostrifikuar për përdorim në Kosovë më 05.09.2018 gjë që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvojë pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

2. Po ashtu ne kërkesën e njëjtë Inxhinieri i ndërtimtarisë Arbon Prekadini ka përfunduar studimet e tij master dhe fituar titullin Master i Shkencave Teknike të Ndërtimtarisë më 15.05.2017 që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvojë pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon:

Kërkesa 2. Menaxher i projektit- Inxhinier i dip. ose kualifikimi Master i ndërtimtarisë ose i Arkitekturës me min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)

Kërkesa 3. Menaxher i Punishtes - Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i Ndërtimtarisë me min. 10 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar.

Kërkesa 4. Stafi i inxhinierve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës -Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv

-Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik - Një (1) inxhinier Mekanik.

Kërkesa 5. Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin. Vendimi për caktimin e menaxherit.

Dëshmia 3. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin.

Dëshmia 4. Inxhinierët të dokumentojnë diplomat universitare (kopje) master apo diploma me studime 5 vjeçare(autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit sipas profilit të drejtimit, CV ,kontratë punës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se nga kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara në piken 2, 3 dhe 4, respektivisht të parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit shihet qartë se janë kërkuar 1 Menaxher i projektit inxhinier i ndërtimtarisë ose i arkitekturës, 1 Menaxher i Punishtes inxhinier i ndërtimtarisë si dhe 5 inxhiniera nga një për secilën fushë respektivisht: Një (1) inxhinier i Arkitekturës, Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik, Një (1) inxhinier Elektrik, Një (1) inxhinier Mekanik.

Bazuar në kërkesat e AK-së, OE pjesëmarrëse është dashur të dorëzojë dëshmitë sipas kërkesës së AK, për 7 inxhinierë që do t'i angazhoj në implementim të kontratës.

Ndërsa Operatori ekonomik ankues ka dorëzuar listën e stafit profesional për këtë projekt në përbërje si vijon:

Nr	Emri	Mbiemri	Mosha	Përvoja	Pozita në Kompani
1	Sinan	Berisha	56 Vite	15 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures **Projekt Menaxher**
2	Samil	Pireci	46 Vite	13 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë **Menaxher i Punishtës**
3	Arbon	Prekadini	34 Vite	11 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
4	Becir	Zecirovic	56 Vite	25 Vite	Inxh.Dipl.Hidroteknikes
5	Lulzim	Kryeziu	46 Vite	21 Vite	Inxh. Dip. Makinerisë
6	Qamil	Hoti	51 Vite	18 Vite	Inxh.Dip.Elektroteknikës
7	Besian	Sinani	35 Vite	6 Vite	Inxh. Dip. Ndërtimtarisë
8	Benjamin	Kabashi	33 Vite	8 Vite	Inxh.Dip. Arkitektures

Mirëpo, OE ankuese nuk ka ofruar dëshmitë konform kërkesës së AK lidhur me Inxhinierin e Ndërtimtarisë z .Arbon Prekadini si dhe Inxhinierin e Arkitekturës z.Benjamin Kabashi.

Për Inxhinieri e ndërtimtarisë z. Arbon Prekadini ka dorëzuar: kontratë pune për kohë të pacaktuar, Cv, diplomën për përfundimin e studimeve master te lëshuar me datën 26.5.2017 nga Fakultetit i Ndërtimtarisë

dhe Arkitekturës në Prishtinë, me te cilën ka fituar titullin Master i Shkencave Teknike të Ndërtimtarisë me 15.05.2017, nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi (referencë apo dokument tjetër) mbi përvojën e punës, andaj nga dëshmitë e bashkangjitura rrjedh se i njëjti nuk ka përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit siç ka kërkuar AK, si dhe për Inxhinierin e arkitekturës z. Benjamin Halit Kabashi para kontratën për angazhim në projekt, Cv, diplomën për përfundimin e studimeve master te lëshuar me datën 15.12.2016 nga Fakultetit i Arkitekturës dhe Dizajn, Universiteti Polis, në Republikën e Shqipërisë, me te cilën ka fituar titullin Master i Shkencave në Arkitekture dhe Dizajn me 23.07.2012, dhe të njëjtën diplomë e ka nostrifikuar dhe njohur gradën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 6 4203 te datës 05.09.2018, nuk është dorëzuar ndonjë dëshmi (referencë apo dokument tjetër) mbi përvojën e punës. Andaj, nga dëshmitë e bashkangjitura rrjedh se i njëjti nuk ka përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit/nostrifikimit siç ka kërkuar AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Eurobesi" Sh.p.k.- Prishtinë që ndërlidhet me arsyen tjetër të eliminimit respektivisht si vijon: kërkesa nr. 5 si me poshtë e kërkuar nga AK ne dosje te tenderit.

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe përgatitje shkollore numri i punëtorëve 30 dhe te ketë kontrata me punëtor ose parakontrata. Punëtorë të profileve të ndryshme.

Ne kemi gjetur këto te dhëna ne listën e stafit te punëtoreve që bien në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe kërkesat e AK.

3. Lista e stafit nuk është e plotësuar me 30 punëtorë sipas dosjes së tenderit. Në listën prej 38 punëtorëve janë të përfshirë edhe punëtoret profesional (inxhinierët), administrative dhe juridik, si dhe punëtorët e ndërtimtarisë.

Bazuar në ARBK N.P. "Euro-Besi" është themeluar me 11.03.2004 si Biznes Individual e cila është shndërruar në SH.P.K. "Euro-Besi" me numër të ri biznesi 71211568 më 30.10.2015, ndërsa kemi gjetur se disa nga punëtorët të cilët janë të përfshirë në listën e stafit kanë kontrata pune të lidhura si p.sh.:

- Personi me nr ID 1019566621 me datë 01.12.2014 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1006445914 me date 01.01.2011 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1179074704 me datë 01.01.2011 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;
- Personi me nr ID 1002777661 (njëkohësisht me vendim për menaxher punishte) me datë 06.01.2014 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;

• Personi me nr ID 1012376720 me date 01.01.2014 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;

• Personi me nr ID 1170555321 me datë 20.03.2012 ka kontratë e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;e."

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon:

Kërkesa 5. Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe përgatitje shkollore numri i punëtorëve 30 dhe te ketë kontrata me punëtor ose para kontrata. Punëtorë të profileve të ndryshme..

Ndërsa, OE ankues "Eurobesi" Sh.p.k.- Prishtinë së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën në të cilën ka përfshirë të dhënat e 38 punëtorëve (në këtë listë ka përfshirë 6 nga 8 inxhinieret te cilët i ka përfshirë edhe në listën e stafit profesional si dhe 4 punëtor të administratës) dhe listën e me të dhënat e 8 punëtorëve/stafit profesional me profile të ndryshme, nga të dy listat rrjedh se OE ankuese për këtë aktivitet të prokurimit ka paraqitur 40 punëtor/staf me profile të ndryshme.

Lidhur me personat/stafin me të dhënat: personi me nr ID 1019566621; Personi me nr ID 1006445914; Personi me nr ID 1179074704 ; Personi me nr ID 1002777661; Personi me nr ID 1012376720 si dhe Personi me nr ID 1170555321, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se për të njëjtit persona OE ankues ka bashkangjitur kopjet e kontratave të punës të cilat janë të nënshkruara në vitet 2011, 2012 dhe 2014 ndërsa të njëjtat janë te vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK e cila është formuar me datën 30.10.2015 respektivisht në vitit 2015 është ndërruar statusi i kompanisë nga "NP EuroBesi" në "EuroBesi shpk' dhe sipas sqarimit te OE ankuese për te njëjtit punëtor te cilët kanë qenë të punësuar në kompani edhe para ndryshimit të statusit ndërsa pas ndryshimit të statusit nga "NP EuroBesi" në "EuroBesi shpk'' janë lëshuar kontratat dhe janë vërtetuar me vulë "EuroBesi shpk''. Po ashtu, OE ankues si dëshmi se bashku me ankesën ka bashkangjitur listat e të punësuarëve të deklaruar në ATK për vitin 2014 dhe 2020 në të cilat lista figurojnë të dhënat e të gjithë personave me numër personal të cilët janë specifikuar më lartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Eurobesi" Sh.p.k.- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar sepse me paragrafin 1.1 të pikës 1 të nenit 60 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Paneli shqyrtues konstaton se AK duhet te kërkoj sqarime shtese konform 59 dhe 72 te LPP-se lidhur me pretendimet e OE ankues "EuroBesi shpk''.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues "N.N. 100%Design" Sh.p.k.&"Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj - Ankesa 873/20

Lidhur me pretendimin e OE ankues "N.N. 100%Design" Sh.p.k.&"Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 56.3, 59 dhe 66 të LPP-së, me arsyetimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me arsyen e eliminimit të saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me dëshmitë e referencave - vlera e punëve të kryera të ngjashme, dëshmitë se projekt menaxheri i ka kryer tri projekte te mëdha-kontratën e skaduar dhe inxhinieri i ndërtimit është me studime bachelor".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listën e projekteve të realizuara nga OE "N.N. 100% Design"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 13,903,937.79 € të kontratave të realizuara nga viti 2014 deri në vitin 2020 si dhe listën e projekteve të realizuara nga OE "Termomontimi" Sh.p.k në të cilën figuron vlera totale prej 3,773,070.30 € të kontratave të realizuara nga viti 2016 deri në vitin 2020, Autoriteti Kontraktues nëse ka dilema per vlerën e qarkullimit te këtyre kontratave mund te kërkoj sqarime shtese se brenda këtyre kontratave a ka te përfunduara pozicione te njëjta Operatori ekonomik Ankues, Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Ndërsa lidhur me dëshmitë e dorëzuar për projekt menaxherin e kontratës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Hajrullah Lushtaku projekt menaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të arkitekturës te lëshuar ne vitin 2006 dhe të vërtetuar tek noteri, CV të nënshkruar, kontratën e punës mbi angazhimin e të njëjtit për aktivitetin në fjalë si dhe referencën e lëshuar nga kompania "N.N. 100% Design"Sh.p.k., këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se në CV dhe referencën e projekt menaxherit është cekur dhjetëra projekte nga te cilat mund të konstatohet se i njëjti ka menaxhuar më shumë se tri projekte të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00 €) sipas kërkesës së AK "së paku tri (3) projekte me vlera të mëdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)". Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "N.N. 100%Design" Sh.p.k.&"Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj, se në dokumentacionin e grupit të OE të rekomanduar për kontratë respektivisht në dëshmitë lidhur me CV e projekt menaxherit, certifikatën e TVSH të partnerit "P&I" si dhe dëshmitë lidhur me vërtetimet tatimore dhe certifikatat e gjykatës për të gjithë partnerët e konzorciumit.". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se grupi i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ka

dorëzuar së bashku me dosjen e tenderit, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Faruk Bytyqi projekt menaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të ndërtimtarisë dhe të vërtetuar tek noteri, CV të pa nënshkruar, kontratën e punës mbi angazhimin e të njëjtit për aktivitetin në fjalë si dhe referencat e lëshuar nga kompania "N.P.N. Bajramaj", këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, sepse përkundër që CV-ja e projekt menaxherit nuk është e nënshkruar, ky është një devijim i vogël i cili nuk përbën element për ndryshim thelbësor apo material të ofertës sepse i njëjti është inxhinier i ndërtimtarisë sipas kërkesës së AK dhe në bazë të referencave të lëshuara për të. Po ashtu, konstatohet se i njëjti ka menaxhuar tri projekte të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00 €) sipas kërkesës së AK *"së paku tri (3) projekte me vlera të mëdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)"*. Si dhe grupi i OE të rekomanduar për kontratë, pas kërkesës së AK para publikimit të formularit "B58 vendimit mbi njoftimi e AK" në platformën e E-prokurimit, kanë dorëzuar në AK, certifikatën e TVSH te partnerit "P&I" si dhe dëshmitë lidhur me vërtetimet tatimore dhe certifikatat e gjykatës për të tre anëtaret e konzorciumit, të gjitha këto certifikata pas sqarimit të kërkuar nga eksperti shqyrtues, ku AK i ka publikuar në platformën e E-prokurimit me datën 05.11.2020 si dhe të njëjtat i ka përcjell tek eksperti përmes e-mailit. Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues "Limit Project"Sh.p.k. &Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë- Ankesa 876/20

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Limit Project"Sh.p.k. &Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së si dhe nenin 39 të RRUOPP, me arsyetimin se:

> "OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me mos dhënien e njoftimit respektivisht mos dërgimit/publikimit të letrës standarde nga AK se pse janë eliminuar, pretendimet mbi arsyet e eliminimit të saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht pretendimit se i plotësojnë të gjitha kërkesat e parashtruara nga AK".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK e ka eliminuar grupin e OE ankues me arsyetimin si vijon:

> "ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK, te publikuara ne dosjen e tenderit te : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr.2,
>
> Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit

për kontratë, te shoqëruar me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 3,200,000.00 €

"Limit Projekt" Sh.P.K., "DAR ING" Sh.P.K., "Rinesa" Sh.P.K., "ARBOTEC" Sh.P.K.

3. Mungon referencat në vlerë prej 3 200 000.00 euro në punë të kryera të ngjashme sipas DT. Nuk hyjnë punimet e përfunduara para datës 08.09.2017 pasi që ato duhen të jenë në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit nga AK. Në referencat e ofruara në DT të ofruara nga OE nuk përkojnë me kërkesat dhe kriteret e kapacitetit teknik dhe professional:

- Renovimet;
- Asfaltimi i rrugëve;
- Fasadimet;
- Punët e instalimeve;
- Punët ujësjells dhe kanalizim;
- Punët e mirëmbajtjeve;
- Furnizimet dhe montimet;
- Punët që janë në vazhdim;
- Komplekset banesore pa pranime teknike nga organet kompetente."

Ndërsa grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listën e projekteve të realizuara nga OE "Limiti" Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 3,168,964.89€ të kontratave të realizuara dhe që janë implementim e sipër nga viti 2019 deri në vitin 2020, listën e projekteve të realizuara nga OE "Rinesa"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 1,958,866.64€ të kontratave të realizuara nga viti 2017 deri në vitin 2020, listën e projekteve të realizuara nga OE "Doring"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 113,847.56 € të kontratave të realizuara nga viti 2017 deri në vitin 2018, si dhe listën e projekteve të realizuara nga OE "Engroup"Sh.p.k. në të cilën figuron vlera totale prej 2,359,993.57€ të kontratave të realizuara nga viti 2016 deri në vitin 2019. Mirëpo, në këto lista janë të përfshira kontrata të cilat kanë përfunduar para dates 08.09.2017 dhe vlerat e atyre kontratave nuk i përkasin periudhës së 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, po ashtu për periudhën e fundit 3 vjeçare në listë janë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, montime, kanalizime, kontratat e kompleksève banesore pa pranime teknike nga palë të treta si dhe vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër (të pa përfunduara). Andaj, Autoriteti Kontraktues nëse ka dilema per vlerën e qarkullimit te këtyre kontratave mund te kërkoj sqarime shtese se brenda këtyre kontratave a ka te përfunduara pozicione te njëjta Operatori ekonomik Ankues, Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "Limit Project"Sh.p.k. &Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë, se nuk janë njoftuar nga AK respektivisht mos dërgimit/publikimit të

letrës standarde nga AK se pse janë eliminuar duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se AK, në platformën e E-prokurimit me rastin e ngarkimit të "B58 vendimit mbi njoftimi e AK" nuk ka bashkangjitur asnjë letrat standarde mbi rezultatet e nxjerra rreth ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe ky fakt vërtetohet edhe nga e-mailat e bashkangjitur me ankesë, me të cilët konstatohet komunikimi i zyrtarëve të AK më përfaqësuesit e operatorit ekonomik, ku është specifikuar se për shkak të problemeve me platformën e E-prokurimit nuk ka qenë e mundur publikimi i letrave standarte në platformën e E-prokurimit. Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "Limit Project"Sh.p.k. &Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë rreth dëshmive/dokumentacionin të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, respektivisht në dëshmitë lidhur me marrëveshjet e konzorciumit/janë prezantuar dy marrëveshje konzorciumi, ku një kompani ka lidhur me dy kompani marrëveshje komplet të ndara me njëra tjetrën në kundërshtim me formimin e grupit sipas ligjit si dhe i njëjti grup ka mangësi edhe tek stafi profesional, përvoja si kompani si grup komplet nuk i përmbushin kriteret në FDT.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dy marrëveshje konzorciumi, respektivisht lideri i grupit ka lidhur marrëveshje të veçanta të konzorciumit me anëtaret tjerë të konzorciumit, praktikë jo e zakonshme. Mirëpo, bazuar në paragrafin e fundit të pikës 71.1 të nenin 27 të RRUOPP ku thuhet *"Deklaratat e kërkuara nen (a),(b) dhe (c)* ***mund*** *të përfshihen në një dokument "* nga kjo rrjedhimisht mund të konstatojmë se bazuar në legjislacionin për prokurim publik nuk është obligative që themelimi i grupit të bëhet vetëm me një marrëveshja/deklarate konzorciumi.

Ndërsa lidhur me pretendimit e cekur sipërfaqësisht pa paraqitur asnjë fakt nga OE ankuese rreth stafit profesional të grupit të OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se grupi i OE të rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit lidhur me stafin profesional kanë paraqitur kopjet e diplomave, CV, kontratën e punës, si dhe referencat mbi përvojën e punës për 9 inxhinier të profileve të ndryshme. Andaj pretendimet e OE ankuese në këtë pikë nuk janë të bazuara.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë- Ankesa 882/20

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 40 dhe 41 të RRUOPP, me arsyetimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankesë lidhur me arsyen e eliminimit të saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me dëshmitë kontratën e punës – inxhinierin/menaxherin e projektit z. Kreshnik Raci dhe dëshmitë lidhur me listën e projekteve te realizuara ne vlere 3, 200, 000.00 € si dhe në krahasim me ofertën e grupit te OE te rekomanduar për kontratë ne vlerë 1,790,297.61 € çmimi i ofertës tonë/OE ankuese ka qenë 1,683, 937.17 € respektivisht nëse shumes1,790,297.61 € i zbritet- 1,683, 937.17 € = 107,000.00 € që paraqet një shume te konsiderueshme dhe se oferta jone i plotëson te gjitha kriteret te cilat kane qene te specifikuara ne njoftimin per kontrate dhe ne dokumentet te cilat e përbejnë dosjen e tenderit."

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankuese është pjesërisht i bazuar sepse grupi i operatorit ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listën e projekteve të realizuara nga OE "Olti Trasing" Sh.p.k., në të cilën figuron vlera totale prej 30,251,554.96 €. Autoriteti Kontraktues nëse ka dilema per vlerën e qarkullimit te këtyre kontratave mund te kërkoj sqarime shtese se brenda këtyre kontratave a ka te përfunduara pozicione te njëjta Operatori ekonomik Ankues, Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Ndërsa lidhur me dëshmitë e dorëzuara për projekt menaxherin e kontratës, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se operatori ekonomik ankues së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar, vendimin me të cilin kanë emëruar z. Kreshnik Raci projekt menaxher, kopjen e diplomës së inxhinierit të arkitekturës te lëshuar ne vitin 2006 dhe të vërtetuar tek noteri, CV të nënshkruar, kontratën e punës për kohe te caktuar e lidhur 01.07.2020 në kohëzgjatje deri më 30.09.2020 (nga te cilat data vërtetohet se kontrata ka qenë me afat në kohen kur u dorëzuar oferta e jo siç kanë konstatuar AK se është e skaduar) si dhe referencat e lëshuar nga kompania "Olti Trasing"Sh.p.k, fondacioni Albanian-American dhe USAID, këto dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në CV dhe referencat e projekt menaxherit janë cekur dhjetëra projekte nga te cilat mund të konstatohet se i njëjti ka menaxhuar më shumë se tri projekte të vlerave të mëdha (mbi 500,000.00 €) sipas kërkesës së AK "së paku tri (3) projekte me vlera të mëdha (sipas klasifikimit të kontratave të LPP-së)". Andaj në këtë pikë pretendimi i OE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë, se oferta e tyre është në shumë të konsiderueshme më e lirë se sa oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe per çdo paqartësi te kërkoj sqarime shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.
Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani";
1x1 OE "Eurobesi" Sh.p.k., Prishtinë;
1x1 OE "N.N. 100% Design"Sh.p. "Termomontimi" Sh.p.k- Skenderaj;
1x1 OE "Limit Project" Sh.p.k.& Daring" Sh.p.k & Engrup"Sh.p.k & "Arbotec" Sh.p.k & "Rinesa" Sh.p.k- Prishtinë;
1x1 OE "Olti Trasing" Sh.p.k – Prishtinë;
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.